



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR APLIKIM PROJEKTESH, 2020

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, në përmbushje të objektivave, funksioneve dhe kompetencave sipas kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; shpall këtë Thirrje për Aplikime Projektesh, 2020 për ato institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias audiovizive.

Subjekte e interesuara në komponentët dhe aspektet e mëposhtme, ftohen që, brenda datës 2 Mars 2020, ora 11.00, të paraqesin dorazi, në zyrën e protokollit të AMA-s propozimin për projektin me temë:

“Studimi i tregut audiovizivë në vendin tonë lidhur me mbulimin e territorit me sinjal bazuar në teknologji të ndryshme (kabllor, tokësor, IPTV, satelitor, etj) si dhe impakti që ka sjellë digjitalizimi i transmetimeve audiovizive”

Nevoja e zhvillimit të këtij projekti është identifikimi i situatës aktuale të tregut audioviziv në vendin tonë si dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së këtij tregu në të ardhmen, referuar zhvillimeve dhe konvergjencës teknologjike.

Projekti duhet të realizojë studimin e tregut mediatik audioviziv duke përcaktuar:

- Shpërndarjen e tregut audiovizive sipas llojit të shërbimit (kabllor, tokësor, IPTV, satelitor etj), duke konsideruar konkurrencën në treg, duke vlerësuar nivelin e aksesit të publikut në transmetimet audiovizive bazuar në këto teknologji, etj.
- Të identifikohet impakti i digjitalizimit të transmetimeve audiovizive në vendin tonë duke marrë në analizë qarqet ku ka përfunduar ky proces, duke konsideruar mbulimin e territorit me sinjal, cilësinë e shërbimit, rritjen e numrit të kanaleve, si dhe trendin e tregut audioviziv;
- Skenarët e mundshëm për zhvillimin e tregut në të ardhmen duke pasur parasysh zhvillimet dhe konvergjencën teknologjike;
- Të analizohet ndikimi i rregullimit të tregut audiovizivë dhe të paraqiten opsione për reforma të reja nëse është e nevojshme.

Projekti do të zhvillohet me dy faza. Gjatë fazës së parë do të grumbullohen të dhënat e nevojshme, do të zhvillohen pyetësorë/anketime nëse do të jetë e nevojshme dhe në fazën e dytë do të kryhen analizat e kërkuara dhe do të nxirren përfundimet/konkluzionet dhe do të përcaktohet një plan i qartë për hapat që duhen ndjekur në të ardhmen me qëllim mbrojtjen e transmetimeve audiovizive dhe sigurimin e investimeve afatgjata të kryera nga operatorë në treg.

Për të gjithë të interesuarit aplikimi, detyrimisht, përshtatet në përmbajtje sipas modelit të formularit që gjendet në faqen online të AMA-s, www.ama.gov.al (Formular për Aplikim Projekt), duke plotësuar çdo kërkesë të tij.

Kërkesa të domosdoshme për të interesuarit:

1. Aplikanti përfshin në dosjen që dorëzon në AMA, veç formularit standard, të plotësuar në secilën pikë, edhe:
 - a. Një informacion të hollësishëm të aktivitetit të institucionit/organizatës në fushën e medias.
 - b. CV-të e gjithë anëtarëve të grupit të punës të projektit,
 - c. Planin e aktiviteteve (me datë dhe tematikë), që parashikon të realizojë nga fillimi deri në përfundim të projektit që propozon.
 - d. Listën e produkteve që parashikon të realizojë nga fillimi deri në përfundim të projektit që propozon.
 - e. Vendimin e Gjykatës për regjistrimin e subjektit aplikues (kopje e noterizuar).
 - f. Numri Identifikues i Personit të Tatuashëm (NIPT).
 - g. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, lëshuar prej administratës tatimore.
3. Në planin buxhetor të projektit të propozuar, vetë aplikuesi, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetëfinancues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.
4. Fondi për të cilin një subjekt mund të aplikojë për t'u financuar nga AMA, nuk duhet të kalojë vlerën 2.500.000 (dymilion e pesëqind mijë) lekë.
5. Aplikuesi duhet të hartojë dhe planifikojë projektin e paraqitur në mënyrë që finalizimi i të gjitha produkteve dhe aktiviteteve, si dhe dorëzimi i të gjithë dosjes së dokumentacionit narativ dhe justifikues financiar të dorëzohen brenda datës 01.10.2020.

Aplikuesit e interesuar, të cilët nuk respektojnë të gjitha pikat e mësipërme do të konsiderohen të skualifikuar.

Aplikuesve, të cilët nuk respektojnë afatin kohor të dorëzimit në protokollin e AMA-s të aplikimit, brenda datës 02.03.2020, ora 11.00, nuk do ju merret në shqyrtim dokumentacioni.

AMA do të vijojë komunikimin dhe procedimin e mëtejshëm vetëm me ata aplikues, të cilëve iu vlerësohet projekti në përputhje me kërkesat e kësaj Thirrjeje.

Për të interesuarit, më shumë informacion për procesin e aplikimit gjeni në Udhëzimin përkatës (Udhëzim për Aplikim), i cili po ashtu gjendet në faqen online të institucionit.

Autoriteti i Mediave Audiovizive

Tiranë 28.01.2020

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME NË FUSHËN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE
FORMULAR PËR APLIKIM PËR FONDE MBËSHTETJE

Pjesa I: Informacione të përgjithshme

Titulli i projektit: [Type text]

Aplikanti (emri i individit ose organizatës që aplikon/partneri I): [Type text] ¹

Statusi ligjor i organizatës që aplikon: [Type text] ²

Numri i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Vendi i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Data e regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

Pozita në organizatë: [Type text]

Tel: [Type text]

E-mail: [Type text]

a. Aplikuesi duhet të depozitojë

-

Kohëzgjatja e projektit: nga data [Type text] deri në datën [Type text]

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: [Type text]

¹ Aplikuesi duhet të depozitojë një CV të detajuar.

² Referuar Udhëzuesit për këtë kriter duhet të depozitohet:

- Vendimin e Gjykatës për regjistrimin e subjektit aplikues (kopje e noterizuar)
- Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT) (nëse është i regjistruar në QKB)
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, lëshuar prej administratës tatimore.

Fusha dhe tema e projektit: [Type text]

Buxheti total: [Type text]

Fondet e kërkuara: [Type text]

Pjesa II: Përshkrimi i projektit

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuarra (*maksimumi 10 rreshta*).

[Type text]

Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

1. [Type text]
2. [Type text]
3. [Type text]
4. [Type text]
5. [Type text]

Lloji i aktiviteteve sipas fushës, p.sh. studime tregu, rritje e zhvillim audiencash, aktivitete trajnuese, hulumtime.etj si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (*maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet*):

1. [Type text]
2. [Type text]
3. [Type text]
4. [Type text]
5. [Type text]

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (*Maksimumi 5 rreshta*):

[Type text]

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve? (*Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 5:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (*Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.*)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe individit ose organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Pjesa III: Partnerët (nëse ka)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (*Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.*)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Struktura. Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Financimi. Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 2

Emri i individit/organizatës: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

E-mail: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Partneri 3

Emri i individit/organizatës: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

E-mail: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Pjesa IV: Buxheti

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruara dhe të mundshme?

Lloji i shpenzimit	≠ e njësisë	Çmimi	TOTAL	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-	AMA
I. Shpenzimet direkte të projektit							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
6.							
7.							
8.							
9.							
10.							
II. Shpenzimet administrative <i>(deri në 15% nga totali i kërkuar)</i>							

1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
<i>Totali i shpenzimeve administrative:</i>							

TOTAL (edhe në %)³:							
---------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

³ Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë AMA dhe vetë aplikantin, qoftë ky individ apo organizatë), edhe si % e buxhetit total për projektin.

UDHËZUESI PËR PROCESIN E APLIKIMEVE TË PROJEKTEVE

Fondi i Autoritetit të Mediave Audiovizive për projektet do të mbështesë propozime të paraqitura dhe të realizuara nga persona juridikë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e studimeve, kërkimeve, aktiviteteve kualifikuese dhe trajnuese, si dhe fushata ndërgjegjësuere në respektim të ligjit dhe akteve nënligjore në fushën e medias audiovizive. Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në Shqipëri, të finalizuara brenda datës së shpallur në Thirrjen për Aplikim.

1. Kush mund të aplikojë?

- a. Mund të aplikojnë persona juridikë publikë, institucione dhe organizata joqeveritare.
- b. Përfshihen projekt-propozimet që synojnë mbështetjen e aktiviteteve mediatike të partive, organizatave, apo lëvizjeve politike.

c. Veç formularit të plotësuar, a duhet të paraqes dokumente të tjera?

Po.

- Një informacion të hollësishëm të aktivitetit të institucionit/organizatës në fushën e medias audiovizive.
- CV-të e gjithë anëtarëve të grupit të punës të projektit.
- Planin e aktiviteteve (me datë dhe tematikë), që parashikon të realizojë nga fillimi deri në përfundim të projektit që propozon.
- Listën e produkteve që parashikon të realizojë nga fillimi deri në përfundim të projektit që propozon.
- Vendimin e Gjykatës për regjistrimin e subjektit aplikues (kopje e noterizuar).
- Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT).
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, lëshuar prej administratës tatimore.

2. Metoda e aplikimit

a. Si duhet të aplikoj?

Shkarkoni formularin për “Thirrje për aplikime projektsh”, në formatin Microsoft Word, më pas plotësojeni atë “offline”.

Formulari i plotësuar, në çdo kërkesë të tij, së bashku me dokumentacionin mbështetës, përcaktuar në pikën 1/c të këtij udhëzuesi, duhen të dorëzohen detyrimisht në një kopje origjinale, dorazi pranë Zyrës së Protokollit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. (*Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Tiranë*)

Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

Drejtuar Zyrës së Protokollit

Aplikim për projekte

Emri i aplikantit: _____

Titulli i projektit: _____

Në raste specifike mund të kërkohet edhe informacion/dokumentacion shtesë. Nga ana tjetër, nuk do të marrim në konsideratë asnjë informacion/dokumentacion shtesë që nuk ju është kërkuar. Në rastin kur aplikuesi është person juridik publik, ose institucion a organizatë joqeveritare, formulari duhet detyrimisht të mbajë firmën e përfaqësuesit ligjor dhe vulën e subjektit.

Nuk mund të aplikoni nëse nuk janë mbyllur procedurat në lidhje me një projekt të mëparshëm tuajin të financuar ose mbështetur nga AMA.

Nuk mund të aplikoni nëse projekti për të cilin jeni mbështetur nga AMA vitin e kaluar, i shtrin efektet e realizimit të plotë edhe gjatë këtij viti.

b. Kur mund të fillojë projekti që kam propozuar dhe kur duhet të mbarojë?

Kur të caktoni datën në të cilën fillon aktiviteti juaj, mos harroni të merrni parasysh jo vetëm kohëzgjatjen e “Thirrje për aplikime projektsh”, por edhe kohëzgjatjen e procesit të vlerësimit të projekt-propozimeve të paraqitura, si dhe periudhën midis shpalljes së fituesve dhe lidhjes së kontratës midis tyre dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive. Gjithashtu, projektet e propozuara duhet të përfundojnë brenda datës së shpallur në Thirrjen për Aplikim

c. Cila është shuma për të cilën mund të aplikoj në AMA?

Në planin buxhetor të projektit të propozuar, vetë aplikuesi, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetëfinancues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.

Fondi për të cilin një subjekt mund të aplikojë për t’u financuar nga AMA, nuk duhet të kalojë vlerën 2.500.000 (dymilion e pesëqind mijë) lekë.

d. Ku mund të kërkoj ndihmë në lidhje me aplikimin tim?

Për informacione të detajuara, vizitoni: www.ama.gov.al, ose shkruani në: info@ama.gov.al

3. Për çfarë mund të aplikoj?

a. Për çfarë lloj aktivitetesh mund të aplikoj?

Financohen dhe mbështeten aktivitete në fushën e mediave audiovizive të cilat përfshijnë: studime tregu, evente shkencore kombëtare ose ndërkombëtare, aktivitete kualifikuese dhe trajnuese me redaksitë e mediave audiovizive, si dhe publikime ose përkthim nga literatura

bashkëkohore mbi performancën e tregut audioviziv, si dhe trendet e zhvillimit të tij brenda Shqipërisë apo në vende të tjera.

b. Si do të vlerësohen kërkesat për financim dhe/ose mbështetje për projekte pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive?

Në procesin e vlerësimit të formularit dhe dokumenteve mbështetës të subjektit aplikues do të merren parasysh:

- objektivat e projektit, aktivitetet apo produktet e propozuara përputhen me kriteret e Thirrjes për Aplikim 2020, politikat dhe strategjitë e Autoritetit të Mediave Audiovizive;
- origjinaliteti i projektit dhe cilësia e aktiviteteve dhe/ose produkteve të planifikuara;
- kapaciteti në terma të burimeve njerëzore dhe ekspertiza teknike për të zbatuar/menaxhuar projektin.
- treguesit e përzgjedhur për matjen e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara janë të përshtatshëm;
- misioni i subjektit aplikues duhet të përputhet me politikat dhe strategjitë e Autoritetit të Mediave Audiovizive;
- subjekti aplikues ka përvoja të suksesshme me partnerë e donatorë të tjerë;
- përpilimi i kostove financiare: kostot të jenë reale (çmimet të jenë të bazuara në referenca dhe të detajuara, ku aplikanti duhet t'i argumentojë dhe t'i justifikojë).
- qëndrueshmëria e projektit dhe impakti në tregun audioviziv.

b. Si duhet të veproj pasi kërkesa ime pranohet?

Nëse kërkesa juaj pranohet, ju do të kontaktoheni për t'u paraqitur pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive për të proceduar me lidhjen e kontratës. Me lidhjen e kontratës dhe fillimin e projektit do të fillojë gjithashtu edhe procesi i monitorimit nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Autoriteti i Mediave Audiovizive

